

## ***Njoftim***

Ky dokument nuk përfaqëson në asnjë rast qëndrim të prerë, detyrues ose përfundimtar të OST-së për përmbajtjen. Ky version publikohet në emër të OST-ve të përfshira vetëm për qëllime të konsultimit publik mbi rregullat e harmonizuara të alokimit. Diskutimi i OST-ve dhe NRA-ve të përfshira në lidhje me draft shtojcën nuk ka përfunduar.

Nëse ndonjëra prej dispozitave të rregullave të harmonizuara të alokimit të paraqitura më poshtë konstatohet se është në kundërshtim me legjislacionin kombëtar në fuqi, rregullat e alokimit për kufijtë përkatës do të ndryshohen për të qenë ose në përputhje me legjislacionin përkatës ose për t'iu referuar legjislacionit përkatës kombëtar.

# **Shtojcë e veçantë për kufijtë e zonës së ofertimit të shërbyer nga SEE CAO e Rregullave të harmonizuara të alokimit për të drejtat afatgjata të transmisionit**

Podgoricë, maj 2022

# TITULLI 1

## Dispozitat e përgjithshme

### Neni 1

#### Lënda dhe fushëveprimi

1. Kjo shtojcë e rregullave të harmonizuara të alokimit për të drejtat afatgjata të transmisionit në nivel të Bashkimit Evropian (në tekstin e mëtejme "HAR") ndërlidhet me nenin 51 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin afatgjatë (në avancë) të kapaciteteve (në tekstin e mëtejme referuar si "Rregullorja e FCA") që nuk zbatohet drejtpërdrejt në kufijtë e zonës së ofertimit jashtë Bashkimit Evropian (në tekstin e mëtejme referuar si "BE"). Qëllimi i kësaj shtojce të HAR-së (në tekstin e mëtejme referuar si "Shtojca") është të përfshijë HAR-në (të ndryshuar nga kjo Shtojcë) në operimin e Platformës së Alokimit. Përveç nëse shprehimisht përcaktohet ndryshe në këtë Shtojcë, dispozitat e kësaj Shtojce zbatohen njësoj në të gjithë kufijtë e zonës së ofertimit të përcaktuar në Shtojcën bashkëngjitime 1 të kësaj Shtojce (Aneksi).

Kjo Shtojcë merr parasysh, aty ku është e zbatueshme, dispozitën mbi parimet e përgjithshme të Rregullores (BE) 2019/943 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 5 qershor 2019 mbi tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe Rregulloren (KE) nr. 714/2009 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 13 korrikut 2009 mbi kushtet e qasjes në rrjet për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike.

2. Aktivitetet e Platformës së Alokimit kanë të bëjnë me juridiksionet e operatorëve të sistemit të transmisionit (në tekstin e mëtejme të referuar si OST) nga Bashkimi Evropian, e OST-ve nga palët kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, dhe juridiksionet e OST-ve nga vendet e tjera për të cilat shërbimet ofrohen nga Platforma e Alokimit. Prandaj, referencat ndaj OST-ve ose operatorëve të sistemit të transmisionit përfshijnë referenca për OST-të e BE-së, operatorët e sistemit të transmisionit nga palët kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, si dhe operatorët e sistemit të transmisionit nga çdo vend tjetër për të cilin ofrohen shërbimet nga Platforma e Alokimit, ndërsa autoriteti rregullator kombëtar (në tekstin e mëtejme të referuara gjithashtu si NRA) përfshijnë referenca për NRA-të e Bashkimit Evropian, NRA-të nga palët kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, ose rregullatorët e vendeve të tjera që kanë juridiksion mbi OST-në përkatëse ose Platformën e Alokimit.
3. Në përputhje me nenin 4 (*Specifikat rajonale*) të HAR-së, specifikat rajonale ose kufitare mund të prezantohen për një ose më shumë kufij të zonës së ofertimit.
4. Rregullat e përshkruara në këtë Shtojcë zbatohen në kufijtë e zonës së ofertimit, siç paraqiten në Shtojcën bashkëngjitime 1 të kësaj Shtojce. Nëse ekziston ndonjë mospërputhje ndërmjet ndonjë prej dispozitave në pjesën kryesore të HAR-së dhe kësaj Shtojce, mbizotërojnë dispozitat në këtë Shtojcë.
5. Termat me shkronja të mëdha të përdorura në këtë Shtojcë përcaktohen në HAR-në, në të cilën kjo Shtojcë është bashkëngjitur, përveç nëse përcaktohet ndryshe më poshtë:

**Llogari e biznesit** nënkupton një llogari të dedikuar të depozitave e hapur nga Platforma e Alokimit me qëllim të sigurimit të kolateraleve në formën e depozitave në para të gatshme nga pjesëmarrësit e regjistruar, të cilat mund të përdoren për pagesa nga pjesëmarrësi i regjistruar;

**Platforma e alokimit** nënkupton Zyrën e Ankandëve të Koordinuara në Evropën Juglindore d.o.o. Podgoricë, Mali i Zi (SEE CAO) dhe zëvendëson termin "Platformë e Vetme e Alokimit" të përcaktuar në HAR;

*Neni 2*

**Data e hyrjes në fuqi dhe zbatimi**

1. Kjo Shtojcë do të hyjë në fuqi në datën e shpallur nga Platforma e Alokimit, në bazë të miratimit të HAR-së dhe kësaj Shtojce nga autoritetet rregullatore kombëtare përkatëse. Kjo shtojcë mund të rishikohet me kërkesë të autoritetit(eve) rregullator kombëtar përkatës. Në rast se kjo Shtojcë duhet të ndryshohet në bazë të një vendimi të autoritetit(eve) rregullator kombëtar përkatës, zbatohet Neni 68 (*Kohëzgjatja dhe ndryshimi i Rregullave të Alokimit*) i HAR-së.
2. Lista e kufijve të zonës së ofertimit (Shtojca 1) për të cilat zbatohet HAR dhe Shtojca, duke përfshirë informacionin mbi llojin e të drejtave të alokuara afatgjata të transmisionit, mund të ndryshohet ose plotësohet në përputhje me dispozitat në lidhje me ndryshimin e HAR-së.
3. Për qëllim të inkorporimit të ndryshimit, kërkohet të konsultohet ose kërkohet miratimi, sipas rastit, i vetëm NRA-së që ka juridiksion mbi OST-në përkatëse, kufiri i zonës së ofertimit të së cilës është ndryshuar ose shtuar.

**TITULLI 2**

**Ndryshimet në HAR**

*Neni 3*

**Recitalet**

Recitalet në HAR zbatohen për të gjitha OST-të, megjithatë, në lidhje me OST-të që nuk janë nga Bashkimi Evropian, ato zbatohen *mutatis mutandis*.

*Neni 4*

**Platforma e alokimit**

Neni 3 (*Platforma e Alokimit*) i HAR-së ndryshohet si vijon:

1. paragrafi 1 thekson: "1. Platforma e alokimit do të ndërmarrë funksionet e alokimit në përputhje me këto Rregulla të alokimit, legjislationin në fuqi të Bashkimit Evropian ose aktet ligjore në fuqi të Komunitetit të Energjisë dhe/ose legjislationin kombëtar të zbatueshëm të një ose më shumë vendeve kufitare të zonës së ofertimit.

*Neni 5*

**Dorëzimi i informacionit**

Neni 9(1) (*Dorëzimi i informacionit*) i HAR-së ndryshohet si vijon:

1. paragrafi (g) thekson: "(g) Kodi i Identifikimit të Energjisë (EIC)";
2. paragrafi (l) thekson: "(l) Kodi i Regjistrimit ACER (Kodi ACER) i caktuar nga Agjencia Evropiane për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER) gjatë procesit të regjistrimit të pjesëmarrësve në treg me NRA-në, për pjesëmarrje në alokim në kufijtë e zonës së ofertimit të paraqitura në Shtojcën e bashkëngjitur 2;

#### *Neni 6*

### **Kërkesat rregullatore dhe ligjore**

Neni 18 (*Kërkesat rregullatore dhe ligjore*) të HAR-së ndryshohet si vijon: "Është përgjegjësi e secilit pjesëmarrës në treg të sigurojë që është në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe, kur është e zbatueshme, legjislacionin e Bashkimit Evropian ose aktet ligjore të Komunitetit të Energjisë, duke përfshirë kërkesat e çdo autoriteti kompetent përkatës, dhe që ka marrë të gjitha autorizimet e nevojshme në lidhje me pjesëmarrjen e tij në ankande ose në transferimin dhe përdorimin e të drejtave afatgjata të transmisionit."

#### *Neni 7*

### **Formulari i Garancisë Bankare**

Neni 21(1) (Formulari i Garancisë Bankare) i HAR-së ndryshohet si vijon:

1. paragrafi (h) thekson: "(h) banka që lëshon Garancinë Bankare duhet të jetë e themeluar në baza të përhershme, duke përfshirë përmes degës në shtetin anëtar të BE-së, Zonës Ekonomike Evropiane, Palës Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, Vendin Vëzhgues të Komunitetit të Energjisë ose në Zvicër dhe duhet të jetë e pranueshme për bankën e biznesit të Platformës së Alokimit;" dhe
2. paragrafi (i) thekson: "(i) banka që lëshon Garancinë Bankare ose grupi financiar të cilit i përket do të ketë një vlerësim afatgjatë kreditor prej jo më pak se BBB- nga Standard and Poor's Corporation, BBB- nga Fitch ose Baa3 nga Moody's Investors Service Inc. Nëse banka emetuese ose grupi financiar, të cilit i përket banka emetuese, ndërpret vlerësimin e kërkuar kreditor afatgjatë, atëherë pjesëmarrësi i regjistruar, brenda pesë (5) ditëve të punës duhet ta dorëzojë në Platformën e Alokimit një garanci bankare zëvendësuese nga një bankë që është në përputhje me vlerësimin e kërkuar kreditor afatgjatë, ose zëvendëson Garancinë Bankare me depozitë. Nëse ka ulje të vlerësimit të institucioneve financiare në të gjithë industrinë, Platforma e Alokimit mund të hetojë se cilat janë standardet e reja dhe, nëse konsiderohet e nevojshme, të ulë vlerësimin e kërkuar për një periudhë të kufizuar kohore, duke informuar OST-të, të cilat më pas do të informojnë NRA-të përkatëse.

#### *Neni 8*

### **Ngjarjet nxitëse dhe pasojat e shkurtimit të të Drejtave afatgjata të transmisionit**

Neni 56 (*Ngjarjet nxitëse dhe pasojat e shkurtimit të të Drejtave Afatgjata të Transmisionit*) i HAR-së ndryshohet si vijon:

1. paragrafi 3 thekson: "3. Të drejtat afatgjata të transmisionit mund të kufizohen pas afatit të qëndrueshmërisë të ditës përpara në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi"; dhe
2. paragrafi 5 thekson: "5. Në rast shkurtimi, pjesëmarrësi i regjistruar i prekur ka të drejtë të pranojë rimbursim ose kompensim sipas:

- (a) Neni 10 (*Afati i qëndrueshmërisë i ditës përpara*) i kësaj Shtojce (në vend të rregullave të përcaktuara në nenin 58 (*afati i qëndrueshmërisë i ditës përpara*) të HAR-it);
- (b) Neni 11 (*Kompensimi për shkurtime për të siguruar operimin mbetet brenda kufijve të sigurisë operationale përpara afatit të qëndrueshmërisë të ditës përpara*) të kësaj shtojce (në vend të rregullave të përcaktuara në nenin 59 (*Kompensimi për shkurtime për të siguruar që operimi të mbetet brenda kufijve të sigurisë operationale përpara afatit të qëndrueshmërisë të ditës përpara*) i HAR);
- (c) Neni 12 (*Rimbursimi për shkurtime për shkak të Forcës Madhore përpara afatit të qëndrueshmërisë të ditës përpara*) të kësaj Shtojce (në vend të rregullave të përcaktuara në nenin 60 (*Rimbursimi për shkurtime për shkak të Forcës Madhore përpara Afatit të qëndrueshmërisë të ditës përpara*) të HAR-it); dhe
- (d) Neni 13 (*Rimbursimi ose kompensimi për shkurtime për shkak të forcës madhore të situatës së emergjencës pas Afatit të qëndrueshmërisë së Ditës Përpara*) të kësaj shtojce (në vend të rregullave të përcaktuara në nenin 61 (*Rimbursimi ose kompensimi për shkurtime për shkak të forcës madhore të situatës emergjente pas Afatit të Qëndrueshmërisë të Ditës Përpara*) të HAR-së)".

#### *Neni 9*

#### **Procesi dhe njoftimi i shkurtimeve**

Neni 57 (*Procesi dhe njoftimi i shkurtimeve*) i HAR-së ndryshohet si vijon:

Paragrafi 3 thekson: "3. Përshkrimi i ngjarjes nxitëse përfshinë informacionin mbi kufirin(jtë) e saktë të sigurisë operationale që pritet të shkelen në mungesë të shkurtimeve, OST-të që thirren në shkurtime dhe pse masat alternative nuk janë të mjaftueshme për të shmangur shkeljen e pritshme të kufirit(eve) të sigurisë operationale. Nëse ky informacion nuk është i disponueshëm në të njëjtën kohë me informacionin e shkurtimeve në lidhje me të Drejtat afatgjata të transmisionit të prekura dhe vëllimin e prekur në MW në orë për çdo periudhë në fjalë, OST-të do të dorëzojnë një njoftim të parë me informacionin e disponueshëm dhe do të përditësojnë informacionin e shkurtimeve duke përfshirë detajet e kërkuara në lidhje me ngjarjen nxitëse brenda 72 orëve pas njoftimit fillestar".

#### *Neni 10*

#### **Afati i qëndrueshmërisë i ditës përpara**

Neni 58 (*Afati i qëndrueshmërisë i ditës përpara*) i HAR-së do të ndryshohet për të theksuar si në vijim: "Platforma e Alokimit publikon në faqen e saj të internetit dhe merr parasysh për llogaritjen e kompensimit për shkurtime e të drejtave afatgjata të transmisionit, afatin e qëndrueshmërisë të ditës përpara siç propozohet nga OST-të përkatëse dhe të miratuara nga NRA-të përkatëse".

#### Neni 11

### **Kompensimi për shkurtime për të siguruar që operimi të mbetet brenda kufijve të sigurisë operative përpara afatit të qëndrueshmërisë të ditës përpara**

Neni 59 (Kompensimi për shkurtime për të siguruar që operimi të mbetet brenda kufijve të sigurisë operative përpara afatit të qëndrueshmërisë të ditës përpara) i HAR-së ndryshohet si vijon:

1. paragrafi 1 thekson: "1. Në rastet e shkurtimit për të siguruar që operimi të mbetet brenda kufijve të sigurisë operative përpara afatit të qëndrueshmërisë të ditës përpara, kompensimi për çdo orë të prekur dhe pjesëmarrës të regjistruar do të llogaritet si të drejta afatgjata të transmisionit në MW për orë që korrespondon me diferencën ndërmjet të drejtave të alokuara afatgjata të transmisionit të mbajtura nga pjesëmarrësi i regjistruar para dhe pas shkurtimit, të shumëzuar me çmimin marginal të ankandit fillestar.";
2. nuk aplikohen paragrafët 2, 3, 4.

#### Neni 12

### **Rimbursimi për shkurtime për shkak të forcës madhore përpara afatit të qëndrueshmërisë të ditës përpara**

Neni 60 (*Rimbursimi për shkurtime për shkak të forcës madhore përpara afatit të qëndrueshmërisë të ditës përpara*) i HAR-së do të ndryshohet për të theksuar si vijon: "Në rastin e forcës madhore përpara afatit të qëndrueshmërisë të ditës përpara, mbajtësit e të drejtave të shkurtuara afatgjata të transmisionit do të kenë të drejtë të marrin rimbursim të barabartë me çmimin e të drejtave afatgjata të transmisionit të vendosur gjatë procesit të alokimit të të drejtave afatgjata të transmisionit, i cili për çdo orë të prekur dhe pjesëmarrës të regjistruar do të llogaritet si të drejta afatgjata të transmisionit në MW për orë që korrespondon me diferencën ndërmjet të drejtave të alokuara afatgjata të transmisionit të mbajtura nga pjesëmarrësi i regjistruar para dhe pas shkurtimit, të shumëzuar me çmimin marginal të ankandit fillestar."

#### Neni 13

### **Rimbursimi ose kompensimi për shkurtime për shkak të forcës madhore ose situatës emergjente pas afatit të qëndrueshmërisë të ditës përpara**

Neni 61 (*Rimbursimi ose kompensimi për shkurtime për shkak të forcës Madhore të situatës emergjente pas afatit të qëndrueshmërisë të ditës përpara*) i HAR-së do të ndryshohet për të theksuar si vijon: "Në rast të forcës madhore ose situatave emergjente pas afatit të qëndrueshmërisë të ditës përpara, mbajtësit e të drejtave të shkurtuara afatgjata të transmisionit do të kenë të drejtë të marrin një rimbursim të barabartë me çmimin e të drejtave afatgjata të transmisionit të vendosur gjatë procesit të alokimit të të drejtave afatgjata të transmisionit, i cili për çdo orë të prekur dhe pjesëmarrës të regjistruar do të llogaritet si të drejta afatgjata të transmisionit në MW për orë që korrespondojnë me diferencën midis të drejtave të alokuara të transmisionit afatgjatë të mbajtura nga pjesëmarrësi i regjistruar para dhe pas shkurtimit, të shumëzuar me çmimin marginal të ankandit fillestar."

#### Neni 14

### **Kushtet e faturimit dhe pagesës**

Neni 65 (*Kushtet e faturimit dhe pagesës*) i HAR-së ndryshohet si vijon:

1. paragrafi 1 thekson: "1. Pagesat do të shlyhen përpara fillimit të periudhës së produktit nëse afati kohor i ankandit e lejon këtë. Nëse produkti i kapacitetit ndërzonal ka një kohëzgjatje prej më shumë se një (1) muaj, çdo këst mujor do të shlyhet në muajin e dytë që i paraprin muajit të dorëzimit, brenda afatit të përcaktuar në kalendarin e ankandit, të publikuar në faqen e internetit të platformës së alokimit";
2. paragrafi 2 thekson: "2. Platforma e alokimit do të lëshojë fatura për pagesa për të gjitha të drejtat afatgjata të transmisionit në baza mujore në përputhje me kalendarin e ankandit, të publikuar në faqen e internetit të platformës së alokimit.";
3. paragrafi 5 thekson: "5. Në rast të shkurtimit të të drejtave afatgjata të transmisionit, ose kthimin e të drejtave afatgjata të transmisionit sipas nenit 40 ose kompensimin e të drejtave afatgjatë të transmisionit sipas nenit 48, pjesëmarrësi i regjistruar do t'i lëshojë faturë platformës së alokimit dhe do ta dorëzojë atë me mjete elektronike siç specifikohet nga platforma e alokimit në faqen e saj të internetit. Pavarësisht, pagesat që do t'u kreditohen pjesëmarrësve të regjistruar mund të shlyhen përmes mekanizmit të vetëfaturimit, i cili lejon platformën e alokimit të lëshojë fatura në emër të pjesëmarrësve të regjistruar dhe për ta.";
4. nuk aplikohen paragrafët 6 dhe 7;
6. paragrafi 9 thekson: "9. Pjesëmarrësi i regjistruar shlyen detyrimet e pagesës që rrjedhin nga paragrafi 3 ose paragrafi 8 të nenit 65 të këtyre rregullave të alokimit, brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas datës së lëshimit të faturës.";
7. nuk aplikohen paragrafët 10 dhe 11;
8. paragrafi 12 thekson: "12. Platforma e alokimit shlyen detyrimet e pagesës që rezultojnë nga paragrafi 5 ose paragrafi 8 i nenit 65 të këtyre rregullave të alokimit, brenda njëzet (20) ditësh pune pas datës së pranimit të faturës."; dhe
9. paragrafi 15 thekson: "15. Të gjitha tarifat bankare mbulohen nga pjesëmarrësi i regjistruar.".

*Neni 19*  
**Ligji rregullues**

Neni 77 (*Ligji rregullues*) i HAR-së ndryshohet për të theksuar si vijon: "Këto rregulla të alokimit do të rregullohen dhe interpretohen në të gjitha aspektet në përputhje me ligjin e Belgjikës, siç specifikohet në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes.".

## Shtojca e bashkëngjitur 1

**Lista e kufijve të zonës së ofertimit për të cilat aplikohet HAR-ja, duke përfshirë informacionin mbi llojin e të drejtave afatgjata të transmisionit të alokuara**

Lista e kufijve të zonës së ofertimit dhe/ose nëngrupet e tyre të interkonektorëve Lista e OST-së përgjegjëse		Lloji i të drejtave afatgjata të transmisionit
<b>Kroaci (HR)</b> HOPS	<> Bosnje dhe Hercegovinë (BiH) NOS BiH	<b>PTR-të</b>
<b>Bosnje dhe Hercegovinë (BiH)</b> NOS BiH	<> Mali i Zi (ME) CGES	<b>PTR-të</b>
<b>Mali i Zi (ME)</b> CGES	<> Shqipëri (AL) OST	<b>PTR-të</b>
<b>Shqipëri (AL)</b> OST	<> Greqi (GR) IPTO	<b>PTR-të</b>
<b>Greqia (GR)</b> IPTO	<> Maqedonia e Veriut (MK) MEPSO	<b>PTR-të</b>
<b>Greqia (GR)</b> IPTO	<> Turqi (TR) TEIAS	<b>PTR-të</b>
<b>Shqipëri (AL)</b> OST	<> Kosova (XK) KOSTT	<b>PTR-të</b>
<b>Kosova (XK)</b> KOSTT	<> Mali i Zi (ME) CGES	<b>PTR-të</b>
<b>Kosova (XK)</b> KOSTT	<> Maqedonia e Veriut (MK) MEPSO	<b>PTR-të</b>

Do të zbatohet kjo listë e kufijve të zonës së ofertimit në të cilët aplikohet HAR, duke përfshirë informacionin mbi llojin e të drejtave afatgjata të transmisionit të alokuara që mund të ndryshohet



ose plotësohet në përputhje me dispozitat e Nenit 2 (Data e hyrjes në fuqi dhe zbatimi) të kësaj Shtojce të veçantë për kufijtë e zonës së ofertimit të shërbyer nga SEE CAO.

## Shtojca e bashkëngjitur 2

Lista e kufijve të zonës së ofertimit ku Kodi i Regjistrimit ACER i caktuar nga Agjencia Evropiane për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER) është parakusht për pjesëmarrje në procesin e alokimit.

Lista e kufijve të zonës së ofertimit	
<b>Kroacia (HR)</b>	<b>Bosnje dhe Hercegovinë (BiH)</b>
HOPS	NOS BiH